

Komuna e Prizrenit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Prizrenit udhëhiqet nga kryetari Ramadan Muja nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).
2. Komuna e Prizrenit ndodhet në jugperëndim të Kosovës. Ajo mbulon një sipërfaqe prej 284km² dhe përfshin qytetin e Prizrenit dhe 74 fshatra. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, Prizreni ka 177.781 banorë.¹ Kësisoj, Prizreni është komuna e dytë më e madhe për nga numri i popullsisë në Kosovë.
3. Komuna e Prizrenit ka 12 drejtori komunale, njëra nga to, për dallim nga komunat e tjera është Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm, kjo për faktin se Prizreni konsiderohet njëra ndër komunat më të vizituara nga turistët. Zhvillimi i turizmit vjen nga ekzistenca e monumenteve të shumta dhe të ndryshme të trashëgimisë kulturore, zonës historike të këtij qyteti, ku bëjnë pjesë kalaja, ura e gurit dhe objektet e banimit të ndërtuara gjatë sundimit afro 500 vjeçar të Perandorisë Osmane.
4. Kuvendi Komunal i Prizrenit ka gjithsej 41 këshilltarë, ku 12 prej tyre janë nga PDK, 11 nga LDK, katër nga AAK, tre nga KDTP, tre nga LDD, nga dy këshilltarë janë nga AKR, PD dhe DNS, si dhe nga një përfaqësues në Kuvendin Komunal janë VAKAT dhe Partia ORA.
5. Në hulumtimin e opinionit publik të realizuar nga UNDP në fund të vitit 2012 i përmbledhur në raportin “Mozaiku i Kosovës,” tregohet se 68% e banorëve të komunës së Prizrenit besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre. Përqindja e atyre që besojnë se vetëm pushteti qendror mund t'i zgjidhë këto probleme, është më e lartë se

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: <http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore%20ALB.pdf>

mesatarja e Kosovës, 25% në Prizren në krahasim me 15% sa është mesatarja e Kosovës.²

6. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë: mungesa e ujit të pijes, lënia anash e trashëgimisë kulturore, mungesa e parkingjeve për vetura, mungesa e kanalizimeve dhe prezenca e ujërave të zeza.³

Problemet kryesore në Komunën e Prizrenit

1. **Ndërtimet në zonën historike.** Prizreni, veçmas në katër vitet e fundit, është mbërthyer nga ndërtimet, disa sosh pa leje nga organet përkatëse. Këto ndërtime janë koncentruar veçmas në zonën e quajtur qyteti i vjetër apo zona historike. Rritja e numrit të ndërtimeve në këtë zonë, besohet që po ndikon në tjetërsimin e pamjes së qytetit. Organizatat lokale kanë bërë evidentime përkatëse të këtij problemi. Sipas tyre, vetëm në tri vitet e fundit në “zonën historike” janë ndërtuar më shumë se 100 objekte të reja.⁴ Një objekt i ri është ndërtuar edhe në afërsi të shtëpisë së “Lidhjes së Prizrenit”, madje ky objekt ka marrë edhe një pjesë të oborrit të kësaj shtëpie.⁵ Për t’i ndaluar ndërtimet në zonën historike, mbi 10 mijë qytetarë të Prizrenit, në verën e këtij viti, kanë nënshkruar peticion ku është kërkuar ndalja e këtyre ndërtimeve.⁶
2. **Mungesa e parkingjeve për vetura.** Komuna e Prizrenit konsiderohet të jetë njëra ndër komunat më të vizituara nga turistët. Problem paraqesin hapësirat e pamjaftueshme të parkingjeve, qoftë për automjete të vogla apo për autobusë. Komuna, në disa pjesë të qytetit herë pas here ka lëshuar njërin krah të rrugëve për parkingje me pagesë, por kjo masë besohet të ketë lehtësuar problemin, por jo edhe zgjidhur atë. Problemi nga mungesa e parkingjeve vërehet veçmas gjatë sezonit të verës.

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

³ Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Prizrenit. 2009. Fq 3. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/30845_Prizreni-raporti%20komunal.pdf

⁴ Organizata “Ec me ndryshe”. Korrik 2013. Komunikatë për media. Burimi: http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_6.pdf

⁵ Portali “Indeksonline”. Shkrim autorial, Ylber Vokshi. 06.02.2013. Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Ndërtimet e reja. Burimi: <http://www.indeksonline.net/?PageID=7&LajmID=47000>

⁶ Portali “Prizren Press”. 2013. Burimi: <http://prizrenpress.com/lajme/xhabali-dhjete-mije-qytetare-kane-nenshkruar-peticionin-kunder-degradimit-urbanistik-te-prizrenit/>

- 3. Prezenca e madhe e lëmshë-kërkueseve.** Qyteti i Prizrenit, kryesisht gjatë muajve të verës mbërthehet nga një numër i madh i lëmshë-kërkueseve. Sipas banorëve të kësaj komune, ata vijnë nga pjesë të ndryshme të Kosovës, por ka edhe nga Shqipëria. Prezenca e tyre vërehet në të gjitha pjesët e qytetit. Lëmshë-kërkuesit shpesh i vënë fëmijët nën moshën dy vjeçare të zhveshur në skajet e rrugës me qëllim të tërheqjes së vëmendjes nga kalimtarët. Janë hasur edhe raste kur lëmshë-kërkuesit kanë përcjellë turistët gjatë gjithë vizitës së tyre me qëllim të marrjes së parave nga ta.⁷ Qendrat për Punë Sociale, të cilat tani janë nën kompetencë të komunave, në bashkëpunim me policinë dhe institucionet tjera, janë të obliguara që të evidentojnë këto raste.
- 4. Derdhja e kanalizimeve në lumin “Lumbardh”.** Qyteti i Prizrenit dhe shumë fshatra të tij, kanalizimet i derdhen në lumin “Lumbardh”. Kjo shkakton kontaminimin e ujit rrjedhës si dhe ndot ambientin. Kanalizimet me ujëra të zeza vërehen të derdhen në lumë edhe në qendër të qytetit, përkaj urës së gurit.
- 5. Prezenca e madhe e mbeturinave në zonën e quajtur ‘Nën kala’.** Këto mbeturina ekzistojnë që nga viti 2004 dhe kjo zonë nuk është pastruar prej asaj kohe. Sasia e mbeturinave inerte dhe të ngurta llogariten të jetë tejet e madhe. Mbeturinat në atë mes shihen nga të gjitha pjesët e qytetit, ngase zona ku ndodhen ato është në pjerrësi relativisht të madhe. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 10% e qytetarëve të kësaj komune e konsiderojnë të ndotur qytetin e tyre, ndërsa 12% e konsiderojnë të tillë lagjen e tyre.⁸
- 6. Reduktimet e ujit të pijes.** Janë dy zona në Komunën e Prizrenit të cilat kanë probleme të theksuara nga reduktimet e ujit të pijes. Ato janë lagjet më të madhe në qytet e quajtur “Ortakoll” dhe “Suzi Mahalla”. Në këto vendbanime, përveç ndërprerjes së ujit të pijes, edhe shtypja e vogël e saj llogaritet si problem. Edhe sipas rezultateve të hulumtimit të UNDP-së, furnizimi i prizrenasve me ujë të pijes është problem i madh. Kësisoj, vetëm 33% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik kanë furnizim të pakufizuar të ujit, në krahasim me mesataren e Kosovës 42%. Njëzet e një përqind kanë ndërprerje të furnizimit me ujë prej 1 deri në 4 orë në ditë, 22% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 16% të tyre ndërprerjet zgjasin më shumë se 11 orë në ditë.⁹

⁷ Portali “Koha”. 10.06.2013. Prizreni me shume lypsar. Burimi:

<http://www.koha.net/?page=1.31.148560>

⁸ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. Fq 129. 2012. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. Fq 128. 2012. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur

- 1. Zona historike e qytetit.** Kjo zonë e qytetit të vjetër paraqet thelbin e identitetit për Prizrenin. Në këtë zonë shtrihen Ura e Gurit, Hamami i qytetit, xhamia “Sinan Pasha” e shek. XIV, Shatërvani i qytetit, Shtëpia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kalaja e Prizrenit, si dhe e gjithë zona që përshkruhet nga Lumbardhi. Gjithë këto i japin Prizrenit veçantinë dhe lashtësinë që kërkohet të ruhet. Sfiduese janë ndërtimet e reja përgjatë kësaj zone, të cilat në disa raste edhe pse behën me leje ndërtimi, llogariten të ndikojnë në tjetërsimin e zonës historike.
- 2. Objektet fetare.** Prizreni llogaritet t’i ketë rreth 28 xhami të vjetra të ndërtuara kryesisht gjatë periudhës otomane. Po ashtu kjo komunë ka pesë kisha katolike, nëntë kisha ortodokse dhe 18 objekte fetare të quajtura tyrbe. Këto objekte kërkohen të ruhen, të mirëmbahen dhe të konsiderohen si pasuri e qytetit.


Trendet Buxhetore në Komunën e Prizrenit

Komuna e Prizrenit në vitin 2013 ka planifikuar 33.6 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, Komuna e Prizrenit ka pasur një rritje prej 8.4 milion euro në shpenzime. Në anën tjetër, të hyrat vetanake pas një ngritje në vitin 2011, kanë pësuar rënie prej 659 mijë euro në vitin 2012 (në total 4.3 milion euro). Raporti i Auditorit¹⁰ ka gjetur se borxhi i grumbulluar nga tatimi në pronë arrin në 5.2 milion euro, ndërsa komuna ka pasur ngecje edhe në mbledhjen e të hyrave nga qiraja. Kjo komunë ka të regjistruara 47.200 prona me ngarkesë vjetore prej 2 milion euro. Deri me datën 31 Gusht 2013, janë realizuar rreth 1 milion euro të hyra nga tatimi në pronë apo 76% nga 1.4 milion euro sa është planifikuar për vitin 2013.¹¹ Siç mund të shihet komuna qëllimisht ka planifikuar vetëm 1.4 milionë euro të hyra nga tatimi në pronë, nën supozimin së nuk do të mund të inkasojë shumën totale nga obligimet e tatimit në pronë.

¹⁰ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Prizrenit Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2012_Shqip_9759.pdf

¹¹ Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Komuna e Prizrenit, Përgjigje në kërkesën e Institutit GAP, 26 Shtator 2013


Figura 1. Buxheti i Komunës së Prizrenit- 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?prizren/2013#/~/prizren>

Në bazë të grafikonit mbi ndarjet buxhetore shohim se përveç shpenzimeve kapitale, llojet tjera të shpenzimeve kanë pasur një trend të pandryshueshëm. Sa i përket kontrollit të shpenzimeve, ZAP-i ka gjetur raste të ndarjeve të tenderëve për të iu shmangur procedurave të hapura, shpërblim të ofertuesve të papërgjegjshëm, pagesa për artikuj jashtë specifikacionit teknik etj.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2013



Sa i përket planifikimit dhe vlerësimit të shpenzimeve për 3 vitet e ardhshme, Instituti GAP nuk ka pasur qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016.

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Prizrenit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.